



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT, PËR THEMELIMIN E QENDRAVE KULTURORE DHE
INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE TË QENDRAVE KULTURORE
DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT”**

➤ **HYRJE**

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin Znj. Entela Çipa, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës, Znj. Elira Dani, Drejtore Juridike në Ministrinë e Kulturës dhe Z. Sofjan Jaupaj, Drejtor i Integritimit në Ministrinë e Kulturës.

Relator për këtë projektligj ishte deputeti Z. Vasil Sterjovski.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

➤ QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kjo do të realizohet nëpërmjet ngritjes së qendrave kulturore dhe informative, të cilat do të prezantojnë kulturën e shteteve respektive nëpërmjet organizimit të eventeve, ekspozitave, ligjëratave letrare, promovimit në media dhe ofrimit të shërbimeve informative për qytetarët e interesuar të të dyja palëve.

Këto Qendra kulturore dhe informative janë qendra shtetërore dhe mënyra e financimit të tyre do të përcaktohet nga secila palë. Qendrat do të ngrihen si pjesë e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, e akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe anasjelltas. Secila nga qendrat do të drejtohet nga një drejtor, i cili emërohet nga qeveria e palës dërguese, ndërsa veprimtaritë e tyre do t’i kryejnë nën udhëheqjen e përgjithshme të kreut të misionit diplomatik të Palës dërguese që po e financon atë.

Hyrja në ambientet e këtyre qendrave dhe në eventet e organizuara prej tyre do të jetë e lirë për qytetarët. Qendra parashikohet të kryejë aktivitete të tilla si:

- Organizimin në mjediset e tyre të një bibliotekë dhe një dhomë leximi si dhe të botojë ose importojnë publikime në lidhje me informacionin kulturor dhe shkencor nga vendi i tyre;
- Shfaqjen e filmave, organizimin e ligjëratave letrare, shkencore dhe të tjera, të shoqëruara, sipas nevojës, me ilustrime vizuale ose shfaqje muzikore;
- Organizimin e ekspozitave fotografive, vizatimeve, afisheve, librave, veprave origjinale ose riprodhimeve të artit;
- Ofrimin e informacioneve për qytetarët e interesuar , publikimin dhe shpërndarjen e buletineve informative të ndryshme përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të komunikimit;
- Mbështetjen në shkëmbimin e programeve radio-televizive sipas marrëveshjet.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr.127, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave dhe është nënshkruar më 3.4.2019, në Washington, SHBA.

➤ EFEKTET FINANCIARE

Projektligji shoqërohet me efekte financiare, të cilat konsistojnë në përjashtimin nga taksat e importit/detyrimet doganore për artikuj si mobiljet, pajisjet e zyrës, filmat, albumet me foto, posterat, librat, disqet, regjistrimet, mjetet edukuese dhe format e ndryshme të produkteve audio-vizuale të nevojshme për organizimin e aktiviteteve nga qendra e palës maqedonase, me kusht që ato të mos përdoren për shitje apo përfitime të tjera në Shqipëri.

Kosto vlerësohet të ketë, gjithashtu, edhe ngritja e qendrave kulturore dhe informative shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përlllogaritja e kostove konkrete në këtë fazë është e vështirë pasi kostot për ngritjen e Qendrës Kulturore Shqiptare do të përlllogariten në momentin në të cilin do të merret vendimi për ngritjen e kësaj të fundit në Maqedoninë e Veriut, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

➤ **DISKUTIME NË KOMISION**

Gjatë prezantimit të projektligjit Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës sqaroi se qendrat kulturore dhe informative, të cilat do të ngrihen pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje do të prezantojnë kulturën e shteteve respektive nëpërmjet organizimit të eventeve, ekspozitave, ligjëratave letrare, promovimit në media dhe ofrimit të shërbimeve informative për qytetarët e interesuar të të dyja palëve.

Relatori për projektligjin Z. Sterjovski theksoi se fokusi i marrëveshjes është zhvillimi dhe forcimi i bashkëpunimit në fushën e kulturës, përhapjen e kulturës shqiptare dhe prezantimin e saj në Maqedoninë e Veriut dhe anasjelltas.

Deputetët, anëtarë të komisionit e konsideruan këtë bashkëpunim kulturor një çështje të mprehtë të politikës së jashtme, dhe shtruan pyetje lidhur me vlerën e shtuar që do të kenë këto qendra si dhe me mënyrën se si konsiderohet elementi shqiptar në Maqedoninë e Veriut.

Duke qenë se këto janë problematika, për të cilat duhet të përgjigjet ministria përgjegjëse për Evropën dhe Punët e Jashtme, kryetarja e komisionit tërhoqi vëmendjen për mungesën e përfaqësuesve të MEPJ, si dhe kërkoi nga ta paraqitjen e parashtrimeve me shkrim, përpara shqyrtimit të projektligjit në seancë plenare.

➤ **PËRFUNDIME**

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATOR
VASIL STERJOVSKI

KRYETARE
MIMI KODHELI